

TË NJIHEMI ME PUSHTETIN VENDOR

Shembull praktik: Bashkia Shkodër



Financuar nga:

TË NJIHEMI ME PUSHTETIN VENDOR

Shembull praktik: Bashkia Shkodër



Financuar nga:



Ky botim u mundësua nga Olof Palme Center në kuadër të projektit **“Rinia si agjent i forcimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe llogaridhënies institucionale në Bashkinë e Shkodrës”** financuar nga Qeveria Suedeze. Mendimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe Lëvizjes Europiane në Shqipëri, dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht mendimet e organizatave mbështetëse.

Hartuar nga EMA dhe IRSH

Punoi: Baisa Sefa
Nensi Shyti
Mona Xhexhaj

Karikatura: Jetmir Lubonja

© European Movement Albania
Tiranë, Tetor 2012



European Movement - Albania
Rr. Brigada VIII, Godina 1/3, Ap.9, Tiranë 1019, Albania
Tel/Fax: +355 4 2253184
www.em-al.org



“Intelektualet e Rinj, Shpresë” (I.R.Sh)
Rr: “Daut Boriçi”, Nr. 874,
Shkoder, Albania
Tel/fax: +35522248476/48811
E-mail: irsh_centre@yahoo.com

Përmbajtja

1.Hyrje	4
2. Problematika në pjesëmarrjen e të rinjve në pushtetin vendor	5
3. Organizimi i qeverisjes vendore në Shqipëri	8
4. Funksionet e qeverisjes vendore	10
5. Organet vendimmarrëse në nivelin vendor	10
6.Shërbimet që ofron qeverisja vendore dhe strukturat përgjegjëse për ofrimin e tyre	14
7.E drejta e informimit dhe procedura e kërkimit të informacionit	18
8. Pjesëmarrja e komunitetit si instrument i nxitjes së transparencës dhe llogaridhënies institucionale	20

1. Hyrje

"No one is born a good citizen; no nation is born a democracy. Rather, both are processes that continue to evolve over a lifetime. Young people must be included from birth. A society that cuts off from its youth severs its lifeline¹."

Kofi Annan

Edukimi dhe kultivimi i një brezi të ri aktiv për tu angazhuar në jetën publike është një sfidë sidomos e demokracive të reja të cilat vuajnë apatinë si dhe mungesën e traditës së pjesëmarrjes në vendimmarrje. Si i tillë, inkurajimi i pjesëmarrjes përmes rritjes së informimit dhe ndërgjegjësimit mbi mekanizmat e ndikimit të politikbërjes është një investim sa për të tashmen, po aq edhe për të ardhmen, duke kontribuar kështu në konsolidimin e demokracisë pjesëmarrëse. Mirëpo, pjesëmarrja ekziston në kushtet e një besimi të ndërsjellë i cili përbën edhe premisën bazë të funksionimit të demokracisë. Kjo pasi në thelb të demokracisë është besimi që përfaqësuesit do të ndjekin interesin e përbashkët të të gjithë qytetarëve prej të cilëve buron legjitimiteti i tyre. Ky besim që ndonjëherë në literaturë e gjejmë të referuar me termin 'kapitali social' e merr zanafillën fillimisht në nivelin vendor, pikërisht në atë nivel të qeverisjes i cili duke qenë më pranë nevojave të përditshme të qytetarëve ka edhe ndërveprimin më të madh

1. Askush nuk lind nje qytetar i mire, asnje komb nuk lind ne demokraci. Me sakte te dyja jane procese qe vazhdojne te permiresohen ne kohe. Te rinjte duhet te perfshihen qe ne lindje. Nje shoqeri qe i perjashton te rinjte dhe i perdor ata si litar shpetimi, eshte e destinuar drejt vdekjes.

me ta. Ndaj dhe njohja e parimeve të qeverisjes vendore, procesit vendimmarrës si dhe hapësirave ligjore që institucionalizojnë marrëdhëniet me publikun e veçanërisht me të rinjtë, si katalizatorë të zhvillimit, janë thelbësorë në kuadër të mirëqeverisjes dhe qëndrueshmërisë të demokracisë.

Mirëqeverisja merr kuptim kur ka reagim nga publiku. Ajo lind në një situatë ndërveprimi midis qeverisë në njërën anë dhe publikut në anën tjetër. Një qeverisje nuk mund të përmirësohet në kushtet e mungesës së aktivizimit të qytetarëve, kur ata nuk reagojnë dhe nuk japin kontribut për mënyrën sesi po qeverisen. Qytetarët në tërësi dhe të rinjtë në veçanti për shkak të cilësive që i karakterizojnë, janë forca shtytëse që duhet të vënë në lëvizje mekanizmat e qeverisjes. Vetëm kur qytetarët reagojnë duke marrë pjesë në forma të ndryshme në vendimmarrje, qeverisjet demokratike të gjendura përballë këtij presioni publik tentojnë drejt vetë përmirësimit. Duke u angazhuar në mënyrë aktive qytetarët kontribuojnë në ndërtimin dhe konsolidimin e një sistemi qeverisës: të përgjegjshëm, në kuptimin që i përgjigjet interesave dhe kërkesave të qytetarëve të tij duke punuar për të ofruar shërbime sa më cilësore; transparent, që është i hapur përkundrejt publikut dhe lejon pjesëmarrjen e tij në masën që ligji e ka parashikuar; demokratik, që respekton shumëllojshmërinë, si dhe të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Me pak fjalë, përmes pjesëmarrjes në qeverisje, publiku ndikon në krijimin e një qeverisjeje që është në funksion të qytetarit dhe interesave të tij.

Lëvizja Europiane në Shqipëri

(EMA) është një organizatë think tank e cila në mënyrë analitike vlerëson fenomenet e ndryshme në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e demokratizimit të vendit. Duke njohur rolin dhe potencialin e të rinjve, ajo i kushton një vëmendje të veçantë iniciativave që synojnë fuqizimin e këtij brezi. EMA tashmë ka krijuar një traditë në zbatimin e projekteve përmes të cilave promovohet demokracia pjesëmarrëse dhe roli i të rinjve në këtë drejtim. Gjithashtu, përmes publikimeve periodike, ajo është shndërruar në një aktor me ndikim në edukimin dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri në kuadër të proceseve të rëndësishme demokratizuese me të cilat përballet vendi.

Në vazhdim të angazhimeve të deritanishme në këtë fushë, EMA është aktualisht duke zbatuar projektin **“Rinia si agent i forcimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe llogaridhënies institucionale në Bashkinë e Shkodrës”**. Ky projekt synon rritjen e përgjegjshmërisë institucionale të Bashkisë së Shkodrës përkundrejt publikut, duke stimuluar pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrjen vendore si një instrument presioni, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe procesit të komunikimit me publikun. Përmes kësaj iniciative të mbështetur nga Olof Palme Center dhe SIDA, EMA në partneritet me Intelktualët e rinj, Shpresë, në Shkodër kanë hartuar këtë publikim i cili synon fuqizimin e të rinjve për të ushtruar potencialin e tyre si agentë të përmirësimit të performancës së qeverisjes vendore përmes informimit dhe ndërgjegjësimin.

Duke marrë në konsideratë nga njëra anë rëndësinë e pushtetit vendor në jetën tonë të përditshme dhe nga ana tjetër rolin e të rinjve si promotorë të zhvillimit, përmes këtij publikimi, EMA ka si qëllim të forcojë lidhjen mes tyre, si një simbiozë e cila shkon në avantazh të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës në kuadër të promovimit të demokracisë pjesëmarrëse. Nisur nga ky synim, krahas një informacioni të përgjithshëm lidhur me organizimin, funksionimin dhe organet vendim marrëse të pushtetit vendor në Shqipëri, broshura i ofron audiencës edhe një informacion më specifik mbi Bashkinë e Shkodrës. Qasja është e tillë që broshura të mos ngelë vetëm në nivelin e përgjithshëm por të zbresë në nivelin më praktik duke ofruar informacione që i nevojiten secilit prej nesh në jetën e përditshme.

2. Problematika në pjesëmarrjen e të rinjve në pushtetin vendor

Situata problematike me të cilën përballet pushteti vendor lidhur me nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve ka shërbyer si pikënisje për hartimin e këtij publikimi. Në fakt, situata nuk paraqitet problematike vetëm në bashkinë e Shkodrës por e tillë është edhe në bashki të tjera të vendit. Apatia e të rinjve për të reaguar në emër të komunitetit ndaj vendimeve apo mos marrjes së vendimeve të pushtetit vendor më shumë se sa një karakteristikë e demokracive të brishta, është karakteristikë e rritjes së hendeut midis komunitetit dhe të zgjedhurve. Një tablo me nota disi më neutrale krahasuar me situatën në Shqipëri, por që mbetet problematike


përsaitakon standardeve demokratike paraqitet edhe në nivelin europian apo edhe botëror. Analiza dhe raporte të ndryshme ndërkombëtare mbi demokracinë vendore tregojnë që ka një rënie të interesit të brezit të ri për të marrë pjesë aktivisht në çështjet që i përkasin pushtetit vendor. Sot të rinjtë shihen gjithnjë e më shumë të shkëputur nga komuniteti duke përvetësuar një kulturë individualiste dhe pasive.

Rezultatet e anketës që EMA ka zhvilluar me 70 të rinj nga qyteti i Shkodrës lidhur me njohuritë e tyre mbi pushtetin vendor dhe se si e vlerësojnë ata performancën e institucioneve vendore në ushtrimin e veprimtarisë përkatëse vërteton pikërisht këto prirje botërore. Sipas këtyre të dhënave rezulton se:

- 39% e të intervistuarve janë të painformuar mbi pushtetin vendor. Kjo është një shifër relativisht e lartë po të marrim në konsideratë faktin që Shkodra është qyteti kryesor universitar i pjesës veriore të Shqipërisë. Si i


- 47% e të intervistuarve nuk janë në dijeni që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për publikun. Kjo mungesë informacioni reflektohet edhe në

A jeni në pë dijeni që mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë të hapura për publikun?




nivelin tejet të ulët të pjesëmarrjes së të rinjve si vëzhgues në mbledhjet e këshillit bashkiak, i cili vlerësohet të jetë vetëm 7%. Ky rezultat vjen si pasojë e mungesës së interesit të të rinjve për tu informuar nga njëra anë si dhe fushatave të cunguara dhe të pamjaftueshme të ndërgjegjësimi që ka ndërmarre vetë Bashkia e Shkodrës.

Niveli i informacionit mbi pushtetin vendor Shkoder



tillë, pritej që niveli i informimit të të rinjve do të ishte në shifra më të larta.


Keni qenë ndonjëherë pjesë e diskutimeve të Këshillit Bashkiak?



- Ndërkohë që lidhur me faktin se sa të përfshirë e shohin të rinjtë veten në vendimarrjen vendore


shifrat janë alarmante. Janë përafërsisht 74.3 % e të rinjve që ndihen plotësisht të përjashtuar nga vendimarrja në raport me 17% që janë disi të përfshirë apo 1.5% mjaftueshmërisht të përfshirë.

- Ndër arsytet që pengojnë përfshirjen tyre në vendimarrje, të rinjtë e intervistuar rendisin si më kryesoren mungesën e informacionit mbi




pushtetin vendor, mungesën e transparencës në përcjelljen e informacionit si dhe mungesën e instrumenteve që adresojnë shqetësimet e tyre.

- Të rinjtë vlerësojnë si të domosdoshme që pushteti vendor të tregojë më shumë vëmendje ndaj sektorëve që lidhen me punësimin e të rinjve, infrastrukturën edukuese,




arsimin dhe turizmin. Në fakt edhe trendet botërore dëshmojnë se papunësia është një ndër problemet madhore me të cilat përballet qeverisja vendore ndjekur nga varfëria, transporti i



papërshtatshëm publik, shërbimi i dobët shëndetësor, etj².

- Ndërkohë që janë po ata sektorë të lartpërmendur për të cilët ata shprehen se përfshirja e tyre në vendimarrjen vendore është e rëndësishme. Ky është



edhe një tregues i cili dëshmon për dëshirën e të rinjve për t'iu imponuar e deri diku për të ndikuar vendimarrjen vendore

2. Marrë nga libri "Demokracia në qeverisjen vendore. Manual mbi pjesëmarrjen, përfaqësimin, konfliktin, menaxhimin dhe qeverisjen" Seria 4 e manualit ndërkombëtar IDEA, fq.17.

në përgjigje të interesave të tyre.

3. Organizimi i qeverisjes vendore në Shqipëri

Republika e Shqipërisë është e organizuar në dy nivele qeverisëse: **qeverisja qendrore** e cila harton dhe zbaton politikat në nivel kombëtar, dhe **qeverisja vendore** e cila duke qenë më afër qytetarëve dhe interesave të tyre, po merr gjithnjë e më shumë kompetenca e përgjegjësi edhe në kuadër të procesit të decentralizimit. Pavarësisht se organet e pushtetit vendor e ushtrojnë autoritetin e tyre në mënyrë autonome nga qeverisja qendrore, ato ruajnë lidhje të vazhdueshme me të, kjo edhe falë kuadrit ligjor që sanksionon qeverisjen vendore në Shqipëri.

Kushtetuta e Shqipërisë, Karta Europiane për Vetëqeverisjen Vendore dhe Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në Shqipëri” (Ligji Organik) janë dokumentet kryesore që ofrojnë një përcaktim të qartë jo vetëm të mënyrës së funksionimit të pushtetit vendor, por edhe të raporteve të tij me qeverisjen qendrore. **Në Kushtetutë** përcaktohet se qeverisja vendore mbështetet mbi parimin e decentralizimit, pra të shpërndarjes së pushtetit. Ndërsa ushtrimi i tij realizohet në përputhje me **parimin e autonomisë vendore, koncepti bazë i Kartës Europiane**, i cili nënkupton të drejtën dhe aftësinë e autoriteteve vendore brenda kufijve të ligjit, për të rregulluar dhe drejtuar një pjesë të konsiderueshme të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore³. Kjo Kartë

3. Manuali për Këshilltarët e Komunave dhe Bashkive, tetor 2003

synon të rrisë hapësirën e qytetarit në vendimmarrje dhe ndikimin e tij në këtë proces, si një ndër themelet kryesore të demokracisë. Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në Shqipëri”⁴, i cili njihet si **Ligji Organik**, frymëzohet nga e njëjta filozofi sikurse Karta Europiane. Ai specifikon qartë parimet e qeverisjes vendore dhe përcakton kuadrin e marrëdhënieve ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore.

Organizimi i qeverisjes vendore është i tillë që të mbahen parasysh lidhjet territoriale, ekonomike, sociale dhe tradicionale mes njësive të qeverisjes vendore. Gjithashtu, ky organizim duhet të përkojë me qëllimin e vetë pushtetit vendor për të siguruar përdorim sa më efikas të burimeve financiare që ka në përdorim si dhe të ofrojë shërbime sa më afër interesave dhe nevojave të publikut. Kështu, nga pikëpamja skematike organizimi i qeverisjes vendore në dy nivele është i tillë:

- **Niveli i parë** ku bëjnë pjesë Bashkitë dhe Komunat të cilat janë njësitë bazë të pushtetit vendor. Funksionet dhe kompetencat e tyre janë përcaktuar në bazë të ligjit organik.
- **Niveli i dytë** i cili përfaqësohet nga qarqet, njësi më të mëdha se dy të parat si për sa i përket territorit, ashtu edhe numrit të banorëve.

Secila prej tre njësive të pushtetit vendor (Bashkitë, Komunat, Qarqet) përbëhet nga nënndarje edhe më të vogla, karakteristikat dalluese midis të cilave janë numri i banorëve që

4. Ligji Nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore në Shqipëri”

popullojnë këto nënndarje si dhe zona gjeografike ku ato shtrihen.

Kështu në rastin e:

Bashkisë nënndarjet janë:


- **Fshat** kur shtrihet në zonat rurale dhe krijohet në një territor me mbi 200 banorë.
- **Lagje** kur njësi shtrihet në zona urbane dhe në një territor me mbi 15 000 banorë.

Komunës nënndarjet janë:

- **Fshatra** pasi përgjithësisht komunat shtrihen në zonat rurale.
- **Qytete** në raste të rralla kur ato shtrihen në zona urbane.

Qarkut nënndarja është:

- **Rrethi** i cili zakonisht përfshin një bashki dhe disa komuna fqinje.



4. Funksionet e qeverisjes vendore

Ligji Organik i njeh njësive të qeverisjes vendore tre lloje funksionesh të cilat dallojnë nga njëra tjetra për sa i përket ekskluzivitetit në gëzimin dhe ushtrimin e tyre. Kështu, njësitë bazë të qeverisjes vendore gëzojnë:

Funksionet e veta - të cilat janë ato funksione që meligji janë dhënë njësive të qeverisjes vendore, për realizimin e të cilave ajo është përgjegjëse si dhe ka lirinë dhe autoritetin të marrë vendime e të përdorë mjete për realizimin e tyre. Në përmbushjen e këtyre funksioneve, të cilat janë ekskluzivisht në përgjegjësinë e bashkive dhe komunave, këto njësi ushtrojnë kompetenca në fushën e:

1. **Infrastrukturës dhe të shërbimeve publike që lidhen me furnizimin me ujë të pijshëm; ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike; ndriçimin e mjediseve publike; administrimin e parqeve, lulishteve dhe zonave të gjelbëruara publike; grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbetjeve, etj.**
2. **Shërbimeve me karakter social, kulturor e sportiv që konsistojnë kryesisht në shërbimin social dhe administrimin e institucioneve që e ofrojnë këtë shërbim; ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore dhe historike vendore, organizimin e veprimtarive sportive, çlodhëse e argëtuese, etj.**
3. **Zhvillimit ekonomik vendor përmes përgatitjes së programeve të zhvillimit**

ekonomik vendor; krijimit dhe funksionimit të tregjeve publike, zhvillimit të biznesit të vogël, etj.

4. **Rendit dhe mbrojtjes civile përmes ruajtjes së rendit publik dhe parandalimin e shkeljeve administrative dhe garantimin e zbatimit të akteve të komunës ose bashkisë si dhe mbrojtjes civile.**

Funksionet e përbashkëta - janë funksione për të cilat përgjegjësia ndahet mes njësive të qeverisjes vendore dhe pushtetit qendror. Secila prej tyre ka kompetenca të ndara të cilat i ushtrojnë në mënyrë autonome.

Shembuj të funksioneve të përbashkëta:

- arsimin parashkollor dhe parauniversitar;
- sistemin e shërbimit parësor shëndetësor dhe mbrojtjen e shëndetit publik;
- mbrojtjen e mjedisit;
- rendin publik dhe mbrojtjen civile

Funksione të deleguara - të cilat kryesisht janë funksione të pushtetit qendror ose të institucioneve të tjera qendrore por që me ligj ose me marrëveshje i kalohen për realizim njësive të qeverisjes vendore. Realizimi i tyre nga njësitë e pushtetit vendor bëhet në mënyrën dhe masën e përcaktuar nga pushteti qendror dhe institucione të tjera qendrore.

5. Organet vendimmarrëse në nivelin vendor

Në çdo njësi të pushtetit vendor krijohen organe **përfaqësuese dhe**

ekzekutive⁵. Për secilën nga njësitë bazë të pushtetit vendor, **Këshilli Bashkiak** është në rolin e:

Organit përfaqësues – i cili zgjidhet nëpërmjet zgjedhjeve për organet e pushtetit vendor të organizuara çdo 4 vjet përmes një votimi të përgjithshëm, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë nga populli⁶. Numri i anëtarëve të tij përcaktohet në varësi të numrit të popullsisë së njësisë. Këshilli Bashkiak Shkodër përbëhet nga 45 Këshilltarë që i përgjigjen respektivisht 113.350 banorëve.

Mbledhjen e tij të parë Këshilli i Bashkiak e zhvillon jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjes nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i Këshillit Bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti. Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë dhe është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve të tij, të shpallur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore. Në mbledhjen e parë të këshillit të bashkisë:

- Zgjidhet komisioni i mandateve;
- Miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
- Këshilltarët bëjnë betimin;
- Zgjidhet kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit;
- Zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen ata me

mandatin e përfaqësimit. Këshilli Bashkiak i qytetit të Shkodrës gjatë punës së tij mbështetet nga 13 komisione të cilat janë:

- 1) Komisioni i Ekonomi-Financës
- 2) Komisioni i Shërbimeve publike
- 3) Komisioni Urbanistë - Asete
- 4) Komisioni Juridik
- 5) Komisioni i Shëndetësisë dhe ambientit
- 6) Komisioni i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- 7) Komisioni i Marrëdhënieve me jashtë
- 8) Komisioni i Kontroll - Revizionit
- 9) Komisioni i Rendit dhe Emergjencave
- 10) Komisioni i Vlerësimit të titujve dhe emërtesave
- 11) Komisioni i Arsimit
- 12) Komisioni i Shërbimeve Sociale
- 13) Komisioni i Mandateve

Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur. Kryesisht aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë.

Organit vendim-marrës – Këshilli ka të drejtë të marrë vendime që lidhen me ofrimin e shërbimeve, vendosjen e taksave, ndërtimin e një lulishteje, etj, vendime drejtpërdrejtë të lidhura këto me mirëqenien dhe mirëfunksionimin e komunitetit. Ky funksion realizohet përmes miratimit të akteve të ndryshme ligjore që lidhen me drejtimin ekonomik, social dhe politik të pushtetit.

Organit politikbërës – Këshilli është përgjegjës për hartimin e politikave

5. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 109 dhe Ligji Organik, Neni 6.

6. Ibid., pika 1.

vendore, ai ka të drejtë të vendosë nivelin e taksave dhe tarifave, të hartojë politika fiskale katër vjeçare, të përcaktojë standardin e shërbimeve, të ngrejë struktura për pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe të hartojë strategji zhvillimi, etj.

Organit mbikëqyrës – Këshilli është përgjegjës për të monitoruar zbatimin e vendimeve dhe politikave të tij nga ana e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore.

Në rolin e organit ekzekutiv për njësitë bazë të pushtetit vendor

më shpesh, sa herë të kërkohet nga Këshilli, raporton para tij për gjendjen ekonomiko-financiare si dhe për probleme të tjera që kanë të bëjnë me funksionet e komunës ose bashkisë. Ai ka të drejtën e zbatimit të akteve të Këshillit si dhe ushtrimin e të gjitha të drejtave, detyrimeve që i janë ngarkuar komunës ose bashkisë me ligj. Gjithashtu, Kryetari gjatë ushtrimit të funksionit të tij ka të drejtën e rikthimit për rishqyrtim në Këshill jo më shumë se një herë të vendimeve, kur vëren se ato cenojnë interesat e bashkësisë.

Disa nga vendimet që Këshilli Bashkiak Shkodër ka marrë së fundmi janë:

Vendim Nr. 38, datë 30.05.2012 "Akordim titulli "Mirënjohja e Qytetit" z. Roland Guli"

Vendim Nr. 57, datë 29.06.2012 "Për zgjatjen e subvencionit për Parkun e Transportit të Udhëtarëve Shkodër sh.a, për shërbimin e transportit publik urban me autobus në qytetin e Shkodrës"

Vendim Nr. 59, datë 29.06.2012 "Miratim i detajimit fond investimesh për objekte të arsimit bazë, miratuar me VKB nr. 14, dt. 12.03.2012"

Vendim Nr. 77, datë 31.07.2012 "Miratim i kriterëve specifike për përfitim të shërbimit të përkujdesit rezidencial pranë Shtëpisë të Moshuarve"


(bashkitë dhe komunat) është **Kryetari**, i cili zgjidhet një herë në 4 vjet. Funksioni i tij është realizimi në praktikë i politikave dhe vendimeve që merren nga Këshilli. Vetëm shtetasit me banim të përhershëm në territorin e njësisë vendore përkatëse kanë të drejtë të zgjidhen në organet përfaqësuese dhe ekzekutive të atyre njësisë bazë të pushtetit vendor⁷. Kjo nënkupton që organet përfaqësuese ashtu sikurse edhe ato ekzekutive dalin nga vetë komuniteti i njësisë vendore përkatëse, dhe për këtë arsye ato ruajnë lidhjen e përhershme me të. **Kryetari i Komunës ose Bashkisë, të paktën një herë në 6 muaj ose**

7. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 109, pika 3.

Edhe në rastin e Qarkut ashtu sikurse edhe për njësitë bazë të qeverisjes vendore, organi përfaqësues është Këshilli. **Këshilli i Qarkut** përbëhet nga kryetarët e komunave dhe bashkive që e përbëjnë atë qark, të dalë proporcionalisht nga zgjedhjet vendore si dhe përfaqësues të tjerë nga këto njësi. Delegimi i anëtarëve të komunave dhe bashkive në Këshillin e Qarkut bëhet gjithmonë në përpjesëtim me popullsinë e tyre. Por në çdo rast ato delegojnë së paku një anëtar⁸. Këshilli i qarkut Shkodër përbëhet nga 46 anëtarë.

Ndërsa për sa i përket organit

8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 110, pika 3.



ekzekutiv, në dallim nga komunat dhe bashkitë ku ekzekutivi është Kryetari, në rastin e qarkut funksionet ekzekutive realizohen krahas Kryetarit edhe nga Kryesia e Këshillit të Qarkut. **Kryesia e Këshillit të Qarkut** përbëhet nga:

- Kryetari
- zëvendëskryetari
- dhe nga 5 deri në 9 anëtarë të tjerë.

Kryetari i Këshillit të Qarkut përfaqëson njësinë vendore në marrëdhënie me organet e pushtetit

qendror, me organet e njësive të tjera të pushtetit vendor, si dhe me persona fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj. Në rastin e Qarkut është **Kryesia e Këshillit të Qarkut** e cila duhet të raportojë në Këshill për gjendjen ekonomiko-financiare të paktën çdo 6 muaj ose më shpesh, sa herë kur kjo kërkohet nga këshilli i qarkut për probleme që kanë të bëjnë me funksionimin e tij. Në ushtrimin e kompetencave të saj, Kryesia e Këshillit të Qarkut nxjerr vendime, të cilat pasi miratohen nga shumica e anëtarëve të pranishëm marrin fuqi detyruese për tu zbatuar.

6. Shërbimet që ofron qeverisja vendore dhe strukturat përgjegjëse për ofrimin e tyre

Pushteti vendor, konceptuar si qeverisje në funksion dhe sa më pranë komunitetit, ofron një sërë shërbimesh pikërisht në përgjigje të nevojave të tij me qëllim garantimin e mirëqenies së komunitetit dhe mbarëvajtjen e funksionimit të tij. Duke patur parasysh që qarku është më i distancuar nga komuniteti atëherë rrjedhimisht edhe sfera e shërbimeve që ai ofron reduktohet kryesisht në ato aspekte që kanë të bëjnë me programet rajonale, zhvillimin urban, kompanitë rajonale të ujit dhe rrugëve rurale që i shërbejnë më shumë se një komune. Në tërësi duhet theksuar se shërbimet që ofrojnë njësitë bazë të pushtetit vendor janë të orientuara në fushën e:

- Shërbimit të gjendjes civile
- Shërbimeve sociale të cilat i vijnë në ndihmë përmes instrumentit të përkrahjes sociale kategorive të ndryshme të shoqërisë, midis të cilëve fëmijëve jetimë dhe të moshuarve
- Shërbimeve të ndihmës ekonomike të cilat bazohen në instrumentin e ndihmës ekonomike për familjet që janë në vështirësi ekonomike për të siguruar një minimum jetik për to, personave me aftësi të kufizuar, invalidëve të punës, etj.
- Shërbimeve publike në të cilat bëjnë pjesë infrastruktura rrugore, transporti publik, sistemi i kanalizimeve dhe ujësjellësit, sistemi i shëndetësisë, mbrojtja

e mjedisit dhe rendit publik, strehimi, etj.

- Arsimit
- Punësimi, mision i cili realizohet përmes zyrave të punës të cilat mundohen të përkrahin shtresat në nevojë dhe punëkërkuesit e papunë të regjistruar në zyrat e punës.

Në rastin e Bashkisë së Shkodrës, sfera e shërbimeve që konkretisht kjo bashki u ofron qytetarëve të saj përbëhet nga:

- **Shërbimi i Gjendjes Civile**, i cili mundëson plotësimin, ndryshimin dhe mbajtjen e regjistrave të gjendjes civile, harton aktet e gjendjes civile, publikon ose jep certifikatat për përmbajtjen e tyre. Gjendja civile përbëhet nga tërësia e të dhënave personale, që vërtetojnë lindjen, ekzistencën, individualitetin e shtetasve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Këto të dhëna shërbejnë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve në marrëdhëniet me shoqërinë dhe shtetin, si dhe për ushtrimin e funksioneve të organeve dhe institucioneve shtetërore. Ndër shërbimet që ofron gjendja civile janë: deklarimi i lindjes, deklarimi i vdekjes, ndryshimi i emrit dhe mbiemrit, transferimi i të dhënave të gjendjes civile, lidhja e martesës, ndarje dhe bashkimi familjar, taksa e akteve dhe e pullës⁹.

9. Marrë nga faqja zyrtare e bashkisë së Shkodrës www.shkodra.gov.al

- **Shërbimi i Ndhimës Ekonomike** ofron ndihmë ekonomike familjeve në nevojë, atyre familjeve të cilave u mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht, ose i kanë ato të pamjaftueshme. Qëllimi i kësaj ndihme është t'i ofroj familjeve në nevojë një bazë minimale të ardhurash financiare për të siguruar jetesën. Krahas familjeve të varfra të tjera kategoritë që mund të përfitojnë nga kjo ndihmë janë: personat me aftësi të kufizuar, invalidët e punës, të verbërit, si dhe paraplegjikët dhe tetraplegjikët.
- **Shërbimi Social** synon shpërndarjen e burimeve ekonomike që ka në dispozicion për të plotësuar nevojat e atyre shtresave të shoqërisë në nevojë me qëllim integrimin e tyre në shoqëri. Një formë e realizimit në praktikë të këtij shërbimi është ngritja dhe funksionimi i qendrave komunitare, të cilat ofrojnë shërbime ditore për shtresa në nevojë të tilla si: fëmijë, gra, dhe për moshën e tretë.
- **Shërbimet publike** të cilat përfshijnë ndriçimin, transportin, përfitime ndihme financiare në raste djegieje banese, leje ndërhyrjeje në infrastrukturë, strehimi dhe shërbimi i varrimit. Sikurse kuptohet përmes këtyre shërbimeve bashkia siguron mirë-organizimin dhe mbarëvajtjen e tërësisë së saj territoriale dhe komunitetin.
- **Arsimi** - sikurse është

përmendur edhe më lart, shërbimet në kuadër të arsimit janë një funksion i përbashkët i qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Ajo që përkatësisht është në përgjegjësinë e Bashkisë së Shkodrës lidhet kryesisht me menaxhimin e arsimit parashkollor si dhe atij universitar. Konkretisht në kuadër të arsimit parashkollor, Bashkia e Shkodrës planifikon shpenzimet për furnizimin me ushqime për vitin kalendarik për kopshtet me drekë; merr kërkesat dhe shqetësimet për problemet e mirëmbajtjes së këtyre institucioneve dhe planifikon fondet për kapërcimin e problemeve; bën arkëtimin e detyrimeve financiare të fëmijëve në kopshtet me drekë, konfirmon frekuentimit real të tyre mujor; është përgjegjëse për krijimin e kushteve higjieno – sanitare të këtyre institucioneve; si dhe merr masa për ngrohjen e ambienteve. Ndërsa në kuadër të arsimit të lartë bashkia është përgjegjëse në bashkëpunim me organet e pushtetit qendror në menaxhimin dhe sigurimin e kushteve të duhura për funksionimin e përshtatshëm të konvikteve.

- **Taksat lokale**, të cilat janë edhe një prej burimeve kryesore të të ardhurave për pushtetin vendor. Gjatë veprimtarisë së saj, Bashkia e Shkodrës i kushton një vëmendje të veçantë menaxhimit dhe mbledhjes së taksave lokale ku bëjnë pjesë:
 - » **taksat vendore të tilla si: taksa mbi biznesin e vogël; mbi**

pasuritë e paluajtshme; mbi kalimin e të drejtës së pronësisë; e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, etj

- » **tarifat vendore të tilla si: tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave, e gjelbërimit; për leje dhe shërbim veterinar; e parkimit të automjeteve; e liçensimit të veprimtarive të transportit, etj**
- » **të ardhurat jo tatimore të cilat burojnë sipasojë ekundravajtjeve administrative¹⁰ si për shembull në rastin e: mos shlyerjes së taksave vendore, ndërhyrjet në hapësirat e gjelbërta, ndërhyrjet në rrjetin e kanalizimeve apo të ndriçimit, ushtrim i aktivitetit pa leje, parkime në vende të paautorizuara, etj.**

Struktura kryesore ku kërkohet dhe ofrohet një shërbim i caktuar, është Zyra e Informimit dhe Marrëdhënieve me Publikun e cila në rastin e

¹⁰ Kundërvajtja administrative quhet shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet shtetërore kompetente e kryer me veprim ose mosveprim dhe për të cilën parashikohet një dënim administrativ.

bashkisë së Shkodrës emërtohet **Qendra e Pritjes dhe Informimit**. Kjo është zyra ku çdokush duhet të drejtohet në rast kur kërkon të marrë një shërbim të caktuar apo ka nevojë për informacion lidhur me shërbimet që ofron bashkia. Kjo qendër njeh dhe vlerëson të drejtat e qytetarëve për të qenë të informuar mbi veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor përmes kërkimit të informacionit. Është pikërisht qendra e informimit dhe pritjes e cila vë në lëvizje dhe realizon komunikimit direkt me publikun. Ajo është hallka e parë e zinxhirit të komunikimit dhe ndërveprimit midis qytetarëve nga njëra anë dhe drejtorive/departamenteve të ndryshme të bashkisë nga ana tjetër. Pas qendrës së pritjes dhe informimit, është drejtoria/departamenti përkatës i cili ka autoritetin dhe përgjegjësinë për t'iu përgjigjur qytetarit lidhur me shqetësimin e tij. Për shembull, në rastin kur qytetari dëshiron të informohet nëse ai është pjesë e kategorive të cilat përfitojnë apo jo ndihmë ekonomike, drejtoria e ndihmës ekonomike është struktura përgjegjëse në dhënien e këtij informacioni të specializuar.

7. E drejta e informimit dhe procedura e kërimit të informacionit

Liria e informimit është një ndër të drejtat themelore të individit e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 23: “Çdokush ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacione për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”. Krahas saj, Ligji Nr. 8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, garanton ushtrimin e të drejtës së informimit mbi dokumentet zyrtare.

Sipas ligjit të lartpërmendur mbi të drejtën për të kërkuar informacion për **dokumentet zyrtare** që kanë të bëjnë me veprimtarinë e organeve shtetërore dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore e ka çdo person fizik apo juridik, vendas apo i huaj pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet. Autoriteti publik është i detyruar nga ligji të japë çdo informacion lidhur me një dokument zyrtar, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

Çdo qytetar ka të drejtë t'i drejtohet një autoriteti publik, qoftë ky institucion i pushtetit qendror apo vendor, përmes një shkrese ku ai specifikon informacionin që kërkon. Afati për dhënien e përgjigjes në rastet kur kërkesa është pranuar si e plotë, është deri në **40 ditë** nga dita e depozitimit të saj, në përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe. Në rastet kur autoriteti publik e ka të pamundur plotësimin e kërkesës brenda afatit 40 ditor, për shkak të

veçantisë së kërkesës ose të nevojës për tu këshilluar me një palë të tretë, atëherë ai njofton me shkrim palën e interesuar, jo më vonë se 7 ditë nga mbarimi i afatit të mëparshëm.

Në qoftë se kërkesa për marrje informacioni nuk konsiderohet e plotë, autoriteti publik vendos për mospranimin e plotë ose të pjesshëm të saj brenda 15 ditëve nga depozitimi. Në rastin e mospranimit të kërkesës, përgjigjja negative, e plotë ose e pjesshme, jepet e arsyetuar, me shkrim nga autoriteti publik.

Nëse do të duhet të përshkruanim me hapa procedurën e kërimit të informacionit atëherë ajo do të ishte e tillë:

Hapi 1: Fillimisht qytetari dorëzon kërkesën/ankesën e tij pranë Zyrës së Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun pranë bashkisë ku ai është banor. Kërkesa/ankesa e tij bazuar në formatin e unifikuar nga vetë ky organ i pushtetit vendor duhet të përmbajë saktë të dhënat dhe kontaktet e tij personale në mënyrë të tillë që të sigurohet një mbarëvajtje sa më e mirë e komunikimit qytetar - pushtet vendor.

Hapi 2: Pas marrjes së kërkesës/ankesës së qytetarit nën administrim nga kjo zyrë fillimisht vlerësohet nëse ajo është e plotë. Me tu konsideruar e plotë, kërkesa/ankesa në varësi të specifikës së saj i kalohet drejtorive përkatëse, të cilat e procesojnë atë.

Hapi 3: Pasi kërkesa/ankesa është proceduar, çka nënkupton kthimin e përgjigjes ndaj kërkesës/ankesës së depozituar nga qytetari, ajo i dërgohet për firmë dhe vulë Kryetarit të institucionit, në rastin konkret


Kryetarit të Bashkisë.

Hapi 4: Është Kryetari i Bashkisë që pasi e ka firmosur dhe vulosur shkresën e ridërgon atë tek Zyra e Informacionit dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Hapi5: Kjo zyrë duke qenë përgjegjëse

në mbajtjen e komunikimit midis njësisë së pushtetit vendor dhe komunitetit, pasi e merr në dorëzim shkresën e firmosur dhe vulosur nga Kryetari, ia përcjell atë qytetarit.

Në mënyrë më skematike hapat e përshkruar më sipër ilustrohen përmes kësaj diagrame:



8. Pjesëmarrja e komunitetit si instrument i nxitjes së transparencës dhe llogaridhënies institucionale

Njohja dhe menaxhimi i interesave publike nga ana e njësive të qeverisjes vendore kërkon kurdoherë të zhvillohet një proces krejtësisht transparent dhe me pjesëmarrje të gjerë të publikut. Në fakt, transparenca dhe pjesëmarrja e publikut përbëjnë një detyrim ligjor, si kërkesë e Kushtetutës ashtu edhe e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore e cila vjen më tej e konkretizuar në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" si dhe ligjin nr. 8503, datë 30. 06. 1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare". Duke qenë parimi bazë i demokracisë dhe kriteri thelbësor në kuadër të mirë qeverisjes, pjesëmarrja kontribuon në përmirësimin e procesit të komunikimit dhe shpërndarjes së informacionit, llogaridhënien institucionale dhe i jep zë atyre që preken drejtpërdrejtë nga zbatimi i politikave publike. Pjesëmarrja e publikut realizohet në dy forma:

1. Pjesëmarrje pasive


- » me anë të së cilës pjesëmarrësit vetëm sa njihen me zhvillimin e proceseve qeverisëse por njohja nuk shoqërohet me veprim. Si të tillë përmendim: publikimin e vendimeve, pjesëmarrjen në mbledhje të organeve të zgjedhura apo në takime informative ku qytetarët janë vetëm dëgjues, informimet e publikut nëpërmjet medias,

anketimet, etj.

2. Pjesëmarrje aktive

- » ku komuniteti, kontribuon në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që shërbejnë për menaxhimin më të mirë të veprimtarisë publike. Si të tilla përmendim: diskutime dhe tërheqje mendimi për projekt/ vendime për probleme të ndryshme në lidhje me funksionet qeverisëse, ballafaqime publike për veprimtarinë e realizuar në menaxhimin e veprimtarisë publike; analiza raportuese para publikut, sidomos në paraqitjen e konkluzioneve pas monitorimit apo kontrolleve të organizuara nga organizma të posaçme; etj.

Pavarësisht formës së pjesëmarrjes përvoja ka treguar se komunikimi i drejtpërdrejtë me publikun, tërheqja e mendimit përmes anketeve apo pyetësorëve, faqet e internetit sikurse dhe media përbëjnë ndër mjetet kryesore dhe më efektive të ndërgjegjësimit, informimit dhe komunikimit me publikun. Është shumë e rëndësishme rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të komunitetit pasi nga kjo buron pjesëmarrja aktive, thelbësore për ekzistencën dhe mirëfunksionimin e demokracisë.



Karikatura: Jetmir LUBONJA

TË NJIHEMI ME PUSHTETIN VENDOR

Shembull praktik: Bashkia Shkodër

